

NEGLIGENT OF THE ALBANIAN LANGUAGE BY ALBANIANS SHPËRFILLJA E SHQIPES NGA SHQIPTARËT

Asllan HAMITI¹

^{*}Corresponding author e-mail: asllan_hamiti@yahoo.com

Abstrakt

Shpërfillja e shqipes është vetëm njëri nga problemet e shumta serioze të shoqërisë shqiptare. Qëndrimin mospërfillës të shqiptarëve ndaj shqipes, nivelin e ulët të kulturës së gjuhës e kanë shprehur shumë rilindës tanë, madje edhe gjuhëtarë, shkrimtarë e intelektualë të tjerë të sotëm. Shqipja po shpërfillet nga familjet e nga institucionet shtetërore në Shqipëri, në Kosovë, në Maqedoninë e Veriut e gjithkund te shqiptarët. Ajo dita ditës po e humb statusin e gjuhës amtare (gjuhës së parë) jo vetëm te shqiptarët e mërgatës, por edhe te shqiptarët që jetojnë në Ballkan. Në këtë kumtesë kemi shprehur shqetësimin tonë, besoj edhe shqetësimin e shumë të tjerëve, për qëndrimin mospërfillës të shoqërisë shqiptare ndaj gjuhës shqipe si dhe keqpërdorimin e saj, me përpjekje që të japim disa aktivitete që duhet ndërmarrë për të përmirësuar këtë gjendje të pamirë.

Fjalë kyçe: *gjuhë amtare, familje, institucion, shoqëri, kulturë e gjuhës, shpërfillje.*

Abstract

The neglect of the Albanian language is only one of the many serious problems of Albanian society. The negligent attitude of Albanians towards the Albanian language, the low level of language culture, have been expressed by many of our revivalists, even linguists, writers and other intellectuals of today.

The Albanian language is being ignored by families and state institutions in Albania, in Kosovo, in North Macedonia and everywhere among Albanians. Day by day, it is losing its status as a mother tongue (first language) not only among Albanians in exile, but also among Albanians living in the Balkans.

In this statement we have expressed our concern, I believe the concern of many others, for the disdainful attitude of the Albanian society towards the Albanian language and its misuse, with an effort to give some activities that should be undertaken to improve this bad situation.

Keywords: *mother language, family, institution, society, language culture, neglect.*

Mospërfillja e shqipes është vetëm njëri nga problemet e shumta serioze të shoqërisë shqiptare. Sentenca e shkrimtarit tonë të madh, Faik Konica: “Ruaje Zot Shqipërinë nga shqiptarët!” për gjendjen e sotme, kur shqipja po shpërfillet, po keqpërdoret e po rrezikohet nga vetë shqiptarët, përshtatet me një thënie të ngjashme “Ruaje Zot shqipen nga shqiptarët!”

As institucionet në Shqipëri, Kosovë e në Maqedoninë e Veriut gjuhës amtare nuk i kushtojnë vëmendjen e duhur. Ajo po keqpërdoret nga shkolla shqipe, sidomos në ligjërimin e arsimit, në tekstet shkollorë, që përkeqësohet edhe me mosinteresimin e nxënësve, mungesën e leximit dhe kulturën e dobët gjuhësore. Në dallim nga ligjërimi i shkujdesur dhe bisedor, që përvetësohen lehtë nga komunikimi i përditshëm; ligjërimi libror kërkon përgatitje cilësore paraprake arsimore e kulturore si dhe përvojë të nevojshme gjuhësore. Nuk mund të kemi shqipe të mirë vetëm me njohjen e ligjërimin të shkujdesur e atë bisedor, pa njohjen e ligjërimin libror.

Në konkurset për punësim asnjëherë nuk kërkohet certifikatë për nivelin e njohjes së shqipes, ndërsa certifikata për anglishten është e domosdoshme. Pothuajse askund nuk kemi të punësuar lektorë të shqipes, edhe pse mjetet e informimit e dokumentet zyrtare janë përplot me gabime gjuhësore. Shqipja është gjuha e parë për shqiptarët. Atë duhet mësuar, përdorur drejt, kultivuar e ruajtur. Nevoja e komunikimit me popuj e kultura të tjera e shtyn njeriun që të mësojë edhe gjuhë të huaja, por vendin e parë e zë gjuha amtare. Çdo intelektual duhet të njohë mirë gjuhën standarde, që është varianti më i plotë, i përpunuar, i normuar dhe mbarëkombëtar, që shërben për të shprehur shkallën më të lartë të komunikimit, të qytetërimit, të kulturës, të shkencës dhe të artit letrar.

I. Moskujdesi i familjeve shqiptare për t'ua mësuar gjuhën amtare fëmijëve të tyre

Shumë brengosëse është dukuria tani shumë e përhapur që fëmijët shqiptarë që lindin e jetojnë në shtete shqiptare ku shqipja është gjuhë zyrtare (apo në mjedise ku flitet shqip) gjuhë të parë të mos e kenë shqipen, po një gjuhë të huaj, rëndom anglishten. Çdokush prej nesh ka vërejtur se fëmijët tanë kohën më të madhe e kalojnë duke ndjekur në telefon ose në kompjuter materiale për fëmijë në anglisht (shumë pak në shqip) dhe rrjedhimisht kontaktet e komunikimi i fëmijëve me prindërit e familjarët në gjuhën amtare është gjithnjë më i paktë. Duke e pakësuar komunikimin me fëmijët tanë, nuk po arrijmë t'ua përcjellin në tërësi as edhe shqipen në variantin dialektor ose gjysmëdialektor, ndërsa shqipen standarde nuk po e zotërojnë as edhe në moshën madhore.

Edhe pse përdorimi i teknologjisë informative është bërë pjesë e përditshmërisë sonë te të gjitha moshat, që normalisht se ka edhe të mirat e veta, megjithëkëtë mendoj se duhet pasur kujdes që të kontrollojmë se çfarë shikojnë fëmijët tanë. Përveç pasojave të shumta të dëmshme shëndetësore, mendore e shpirtërore që ka përdorimi i tepërt i aparateve digjitale të komunikimit, ky izolim i fëmijëve nga familja e mjedisi ku jetojnë mund të sjellë edhe shumë të këqija të tjera: autizëm, të folurit e vonshëm, pagjumësi, shpërqendrim, mospasiguri, dështim, nervozizëm, stres, pengimin e procesit të shoqërizimit të tyre e shpëputje nga jeta reale, që e shoqërojnë njeriun gjatë gjithë jetës. Kjo ka për pasojë edhe mësimin e hershëm të anglishtes (ose ndonjë gjuhë vjetër të huaj) dhe përvetësimin e vonshëm të shqipes.

Është e çuditshme, por e vërtetë se kam dëgjuar te ne fëmijë të lindur në familje tërësisht shqiptare që fjalët e para që thonë janë në anglishte e jo në shqipe. Madje, më parë mësohen të flasin anglisht e më vonë shqip. Materiale nga interneti në gjuhë të huaja (shumicën në anglisht) të rinjtë tanë vazhdojnë të ndjekin edhe në moshën e shkollës fillore e të mesme si dhe gjatë gjithë jetës. Rrjedhimisht, ka shumë shqiptarë që flasin shumë mirë gjuhë të huaja, por të paktë janë ata që zotërojnë mirë ligjërimin libror të shqipes. Rrjetet sociale të komunikimit mbushullojnë me këtë substandard shkrimi, me tejbartjen (transkriptimin) e idiolektit në formë të shkruar, zakonisht duke shkruar njësh fjalët sipas shqiptimit e unitetit theksor e jo me ruajtjen e nevojshme e të domosdoshme të kufirit morfologjik të fjalëve.

II. Keqpërdorimi e vë në rrezik shqipen

Shqipja standarde po anashkalohet e po keqpërdoret nga institucionet e nga shumë individë. Me fjalë të tjera, as institucionet në Shqipëri, në Kosovë e në Maqedoninë e Veriut gjuhës amtare nuk i kushtojnë vëmendjen e duhur. Shqipja po keqpërdoret nga shkolla shqipe, si në ligjërimin e disa arsimtarëve, në tekstet shkollore, që përkeqësohet edhe me mosinteresimin e nxënësit, mungesën e leximit dhe kulturën e dobët gjuhësore.

Po të vizitosh ndonjë shkollë fillore a të mesme, pa dyshim se do të vësh shumë gabime gjuhësore në tabelën e shpalljeve, shkrimet e varura në mur si në orarin e mësimit, njoftim, informatë e në gjithçka të shkruar shqip. Edhe dokumentet zyrtare të tyre janë plot me shkarje gjuhësore, edhe pse në atë shkollë mund të punojnë disa mësimdhënës të gjuhës shqipe. Të paktë janë arsimtarët që ligjërojnë në shqipen standarde, meqë disa flasin në dialekt ose në gjysmëdialekt. Tekstet mësimore, veçmas librat shkollorë të përkthyer në RMV, kanë një gjysmëshqipe.

Në dallim nga ligjërimi i shkujdesur dhe bisedor, që përvetësohen lehtë nga komunikimi i përditshëm; ligjërimi libror kërkon përgatitje cilësore paraprake arsimore e kulturore si dhe përvojë të nevojshme gjuhësore. Nuk mund të kemi shqipe të mirë vetëm me njohjen e ligjërimin të shkujdesur e atë bisedor, pa njohjen e ligjërimin libror. Interneti në shqipen ka po të njëjtin ndikim, sikurse edhe në gjuhët e tjera. Krahas ndikimit të fuqishëm të anglishtes, ai ka hapur rrugë përdorimit të të gjitha variacioneve gjuhësore standarde, gjysmëstandarde e jostandarde të shqipes. Pra, në Internet gjejmë të gjitha variacionet e shqipes e sotme. Rinia jonë po lexon tekste të çoroditura nga interneti, ndërsa gjithnjë e më pak tekste me vlerë shkencore, letrare e gjuhësore që do të shërbenin, veç tjerash, edhe në ngritjen e kulturë së gjuhës.

Si të përmirësojmë këtë gjendje të pamirë?

1. Shqipja duhet të jetë gjuhë e parë, gjuhë amtare për të gjithë shqiptarët, pavarësisht se ku jetojnë

Nevoja e komunikimit me popuj e kultura të tjera e nxit njeriun që të mësojë edhe gjuhë të huaja, por vendin e parë e zë gjuha amtare. Nga ana tjetër, sa më mirë e njohim gjuhën amtare, kulturën tonë; aq më mirë do të mësojmë gjuhët dhe kulturat e tjera. Siç dihet, shqiptarët e shqipja në rrjedhë të kohës kanë qenë të rrezikuar nga perandori e pushtues të shumtë, madje me përpjekje të vazhdueshme për vrasje, dëbim, asimilim, shfarosje e pastrim etnik. Por, fatmirësisht populli shqiptar bashkë me gjuhën e tij ka arritur t'u bëjë ballë të gjitha rrebesheve të deritashme dhe të mbijetojë. Megjithëkëtë, faktorët jashtëgjuhësorë kanë lënë gjurmë të pashlyeshme edhe në gjuhë.

Gjuha shqipe ka qenë dhe është e rrezikuar nga armiqtë e jashtëm (gjuhët e kulturat e huaja), por mund të jetë e rrezikuar edhe nga armiqtë e brendshëm (nga keqpërdoruesit e saj, pra nga shqiptarët). Në këtë pikëpamje, ndikimet e gjuhëve të huaja në shqipen vështirë se mund të shlyhen, meqë në gjuhën e sotme shqipe pasqyrohet rrugëtimi i popullit shqiptar gjatë historisë. Në rrjedhë të kohës shqiptarët kanë pasur kontakte me popuj të ndryshëm, dhe si rezultat i këtyre marrëdhënieve gjuha shqipe ka shtresa fjalësh të gurrës vetjake a vendëse të cilat mbizotërojnë, po edhe jo pak fjalë nga gjuhë të huaja.

Shumica e huazimeve latine, greke, turke, sllave, frënge, italiane, angleze e sidomos ndërkombëtarizmat janë mishëruar aq thellë në shqipen saqë vështirë se nuk mund të zëvendësohen me fjalë shqipe. Pra, ndikimi i jashtëm në shqipen është rezultat i kontakteve dhe marrëdhënieve ekonomike, politike, kulturore etj. me pushtuesit, me popujt fqinj si dhe me gjuhët e kulturat me prestigj. Kjo histori jona e deritanishme nuk mund të zhbëhet. Por, çfarë mund të bëjmë sot? Ne duhet të kujdesemi që:

- a) ndikimi i jashtëm i gjuhëve të tjera në shqipen të jetë sa më i vogël, si dhe
- b) ta mësojmë dhe ta përdorim drejt gjuhën standarde shqipe.

2. Ta kultivojmë dhe të mos e copëzojmë shqipen

Në këtë kohë të globalizimit, ne nuk guxojmë të mbyllemi vetëm në guaskën tonë. Do të jemi të hapur me të gjithë popujt, gjuhët e kulturat e botës. Në gjuhë, p.sh. përparësi duhet t'u japim elementeve anase të shqipes, mandej ndërkombëtarizmave si dhe huazimeve që tanimë janë mishëruar në shqipen. Ka edhe shumë fjalë të huaja që nuk e kanë fituar ende statusin e qytetarisë (shtetësisë) në shqipen e që lehtësisht mund të zëvendësohen me fjalë që i ka ose me fjalëkrijime të reja. Në gjuhësi janë të njohura rrugët e pasurimit të leksikut: nga leksiku popullor, nga veprat letrare, nga mundësia e pashtershme e krijimit të fjalëve të reja me brumin e vetë gjuhës e me mënyra të shumta fjalëformimi (me parashtesim, prapashtesim, parashtesim e prapashtesim njëherazi, nyjëzim, kompozim, përngjitje etj.).

Fjalët e huaja, kurdoherë janë si malli që importohet. Do të importojmë ndonjë mall vetëm atëherë kur nuk e prodhojmë dot. Për sa i përket terminologjisë, thotë prof. Gjovalin Shkurtaç, të gjitha gjuhët marrin terma e fjalë nga gjuhët e tjera, sidomos nga anglishtja dhe gjuhët e mëdha të Evropës, porse shqipja po merr më shumë. Një pastrim patjetër që mund dhe duhet të bëhet.¹²³ Kategorinë më të panevojshme të huazimeve e përbëjnë barbarizmat. Barbarizmat janë huazime koti, të panevojshme, meqë kemi fjalë gjegjëse për to. Ashtu siç ka doganim mallrash, duhet të ketë edhe doganim fjalësh. Kohëve të fundit po dëgjojmë e lexojmë edhe sintagmat: shqipja e Shqipërisë, e Kosovës, e Maqedonisë; për të dalluar të njëjtën gjuhë (shqipen) me ngjyrimet territoriale, përkatësisht shtetërore, sipas modelit anglishtja e Anglisë, e ShBA-së, Skotlandës, Nigerisë etj.

Microsofti e ka ndarë shqipen në tri variante: shqipja (e Shqipërisë), shqipja (e Kosovës) dhe shqipja (e Maqedonisë së Veriut). S'do mend se një përcaktim i tillë i shqipes standarde është i pambështetur. Zbatimi praktik i normave të një kombi që kanë një gjuhë standarde ka të bëjë me nivelin individual të shkollimit, të kulturës së gjuhës e të ngritjes së përgjithshme intelektuale e jo me përkatësinë shtetërore të shqiptarëve. Ka folës krahinash e shtetesh të ndryshme që ose e zotërojnë mirë shqipen standarde ose nuk e zotërojnë ose flasin në dialekt.

3. Testimi i administratoreve për nivelin e zotërimi të shqipes standarde

Shumë gjuhëtarë kanë shprehur mendimin se të gjithë përdoruesit e shqipes në punën e tyre publike duhet të zotërojnë mirë shqipen standarde. Në konkurset për punësim në institucionet shtetërore (si në administratë etj.) në tri shtetet ku shqipja është gjuhë zyrtare (në Shqipëri, në Kosovë e në Maqedoninë e Veriut) kandidatët duhet t'i nënshtrohen një testi për të parë nivelin e zotërimi të shqipes standarde, pra për të konstatuar si dikush di të shkruajë shqip apo jo. Lekturimi i të gjitha testeve të shkruara është i domosdoshëm. Për të siguruar zbatimin e shqipes standarde, si dhe përgjithësisht zbatimin Ligjin për përdorimin e shqipes në Maqedoninë e Veriut (në formën e shkruar dhe të folur) në çdo institucion, përveç përkthyesve nga shqipja në maqedonisht e anasjelltas, duhet punësuar lektorë të shqipes.

¹²³ Gjovalin Shkurtaç, *Urgjenca gjuhësore*, Naimi, Tiranë, 2017, f. 12.

4. Redaktimi profesional e gjuhësor i të gjitha teksteve të jetë i detyrueshëm

Si tekstet e përkthyer, ashtu edhe shkrimet origjinale në gjuhë amtare duhet rilexuar, ndrequr e përmirësuar për ta sjellë në formën e duhur përfundimtare. Shumëkush mendojnë gabimisht se shkrimtarët apo përkthyesit janë njerëz që kanë prirje të madhe për të shkruar, prandaj nuk hasin në kurrfarë vështirësish gjatë hartimit a përkthimit të veprave. Mirëpo, ata që kanë pasur mundësi të gjurmojnë punën krijuese të shkrimtarëve, flasin ndryshe. Për kujdesin dhe mundin e tyre dëshmojnë shënime të shumta që na kanë lënë shkrimtarët dhe versionet e shumta të veprave, deri në formën përfundimtare të tyre.¹²⁴

Të gjithë ata që kanë provuar të hartojnë madje edhe një tekst prej 5-6 rreshtash, qoftë edhe një shkresë të thjeshtë administrative, artikull gazetaresk, apo një punim të shkurtër do të pohojnë se nga forma e parë shkrimore e deri në formën përfundimtare duhet bërë shumë punë me përkushtim. Një praktikë e përmirësimit të veprave edhe pas botimit ndiqet me ribotime (deri më dhjetëra herë), duke përmirësuar ato jo vetëm në përmbajtje, por edhe në gjuhë e stil, duke hequr gjërat e panevojshme, përditësuar e ngritur cilësinë e veprës. Gjërat jo të mira mund të ndreqen, gjërat e mira mund të bëhen edhe më të mira.

Prof. Xhevat Lloshi në librin *Stilistika dhe pragmatika*, Tiranë, 1999 na sjell të dhëna shumë domethënëse për këtë çështje. Sipas këtij albanologu “Shumica e shkrimtarëve kanë mbajtur shënime në fletore të veçanta, duke regjistruar me kujdes fjalë e fraza të ndryshme, të cilat i kanë dëgjuar në popull ose i kanë gjetur të shkruara nëpër libra, revista, gazeta etj., që dëshmojnë zellin e tyre në lëvizimin e gjuhës. Kështu, siç dihet, Maksim Gorki nuk e kishte dorëzuar një tregim në shtyp në kohën e paraparë derisa iu kujtua një fjalë e nevojshme që assesi nuk i kujtohej. Floberi shkruan se “po mbushet gati një muaj qyshkur po përpiqem të gjej katër fraza të shkreta që po më nevojiten.”

Balzaku në një letër pohon se “secilën faqe e kam shkruar nga 50 deri më 60 herë. Nuk ka asnjë tabak shtypi ndër veprat e mia, që të mos e kam korrigjuar nga 17, 18 apo 19 herë“. Gogoli, duke folur për punën e vet krijuese, shprehet se “së pari duhet të hudhen në letër që të gjitha, ashtu siç i bien ndërmend njeriut, qoftë edhe keq, turbull dhe duhet harruar ajo fletore. Pas një a dy muajsh, herë-herë edhe më tepër lipset të merret dhe të lexohet ajo që është shkruar: Do të shihni se shumë sende nuk qëndrojnë ashtu, se ka shumë gjëra të tepërta, e që aty-këtu mungon diçka. Bëni korrigjimet dhe vërejtjet në margjinë dhe përsëri lëreni fletoren. Pas një kohe, këtë version kopjojeni me dorën tuaj. Gjatë kësaj pune vetvetiu do të lindin mendime të reja, shkurttime, shtesa, pastrimi i stilit, ndërmjet fjalëve të mëparshme do të lindin fjalë të reja, të cilat e kanë vendin aty medoemos, por që, nuk e di pse, nuk shfaqen menjëherë...“¹²⁵

Shembujt e sjellë nga puna e kujdesshme që kanë bërë disa nga shkrimtarët më të mëdhenj botërorë na bëjnë shumë të qartë se sa herë që shkruajmë, qoftë tekste origjinale apo të përkthyer, duhet me patjetër që punën tonë ta rishikojmë disa herë, përkatësisht ta lexojmë me syrin kritik, ta rilexojmë sa më shumë aq më mirë, ta përmirësojmë e të shkrijmë gjithë dijen tonë. Me fjalë të tjera, teksti i hartuar nga kushdo ose i përkthyer së pari duhet të redaktohet nga vetë autori ose përkthyesi. Kuptohet se gjatë redaktimit, është mirë të shfrytëzojmë programin kompjuterik për përmirësimin e gabimeve drejtshkrimore, të konsultojmë materiale të tilla a të ngjashme të botuara; përkthyesi të konsultojë nëse është nevoja edhe kolegë e profesionistë të fushës, fjalorë shpjegues, drejtshkrimorë, terminologjikë, dygjuhësh e shumëgjuhësh, fjalorë enciklopedikë etj.

¹²⁴ Asllan Hamiti, *Shtjellime gjuhësore*, Grafoden, Shkup, f. 62-63.

¹²⁵ Xhevat Lloshi, *Stilistika dhe pragmatika*, Tiranë, 1999.

Pasi ta ketë kryer me kujdes redaktimin të tekstit, materiali duhet lexuar, kontrolluar e përmirësuar nga një profesionist i fushës së lëmit të tekstit të përkthyer. Redaktori profesional është mirë të jetë specialist i fushës, ai që njeh mirë gjuhën e specializuar, përkatësisht termat përkatës. Fjala vjen, për një tekst të përkthyer nga maqedonishtja në shqip që i përket stilit shkencor, fushës së Të drejtës ndërkombëtare, redaktori profesional duhet të ishte jo vetëm jurist, por specialist i Të drejtës ndërkombëtare; për një tekst mësimor të përkthyer për shkolla të mesme të mjekësisë – redaktori profesional duhet të jetë së paku mjek etj. Të gjitha fushat e veprimtarisë njerëzore kanë ligjërimin profesional me përplot emërtesa. Vetëm specialisti njeh mirë gjuhën e specializuar, përkatësisht termat. Siç kanë konstatuar stilistët, në stilin shkencor pjesa e leksikut të përgjithshëm mund të bjerë deri përgjysmë. Gjysma tjetër i takon leksikut shkencor.¹²⁶ Këtë leksik shkencor e njeh mirë vetëm profesionisti i fushës. Sa parimore do të ishte kur mjeku flet për mjekësi, bujku për bujqësi, teologu për teologji...!¹²⁷

Në praktikën e deritashme të përkthimit në Maqedoninë e Veriut përgjithësisht na ka munguar redaktimi profesional. Mendojmë se në të ardhmen tekstet e përkthyer medoemos duhet të kalojnë nëpër glosarin terminologjik të redaktorit profesional. Pas redaktimit profesional, tekstit të përkthyer si edhe çdo teksti tjetër, duhet bërë një redakturë gjuhësore, shpeshherë të quajtur edhe lekturë ose korrekturë. Redaktori gjuhësor apo siç e quajnë edhe “rojtari” i rregullave gjuhësore¹²⁸ e ka për detyrë tekstin e përkthyer ta shqipërojë, përkatësisht ta sjellë në formën sikur të jetë shkruar drejtpërdrejt në shqip. Ai duhet t’i bëjë të gjitha përmirësimet e nevojshme si dhe të kujdeset për tekstin edhe pas përpunimit teknik e deri në botimin përfundimtar. Gjuha e tekstit duhet kundruar e rregulluar në çdo pikëpamje: kuptimore, leksikore, morfosintaksore, stilistike, drejtshkrimore dhe se teksti i përkthyer është barasvlerës me origjinalin.

Praktikën e redaktimit profesional e gjuhësor e zbatojnë edhe shtetet e tjera të Evropës, përfshirë edhe vendet ballkanike. Po mjaftohemi me këtë rast të përmendim praktikën e kujdesit që tregojnë individët dhe institucionet për përdorimin e maqedonishtes standarde. Këshilli për Gjuhën Maqedonase, që funksionon në kuadrin e Qeverisë së Maqedonisë së Veriut në dhjetor të 2019 ka hartuar dhe dorëzuar për miratim po të njëjtin institucion një Propozim-ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për përdorimin e maqedonishtes.¹²⁹

Ligji i propozuar parashikon angazhimin ose punësimin e detyrueshëm të lektorëve të gjuhës maqedonase në të gjitha institucionet shtetërore e publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut, si në Qeveri, në Kuvend, në të gjitha ministritë, institucionet e qeverisjes lokale, universitetet, institucionet shkencore, shkollat e mesme dhe filloret, mediet dhe në të gjitha veprimtaritë e tjera të jetës shoqërore të vendit, si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat. Me këtë propozim-ligj edhe mësimi i maqedonishtes është i detyrueshëm në të gjitha institucionet e arsimit të lartë në dy semestra, që nuk ishte praktikë deritashme. Për herë të parë parashihen edhe ndarjen e bursave për studentët e gjuhës dhe letërsisë maqedonase në tri ciklet e arsimit të lartë (në studime themelore, master e doktorat) dhe në të gjitha universitetet e vendit.¹³⁰

¹²⁶ Po aty.

¹²⁷ http://infrastrukturerrugore.weebly.com/uploads/2/5/9/7/25973304/shkrimi_akademik_leksione.pdf

¹²⁸ Gjovalin Shkurtaj, *Si të shkruajmë shqip (Baza të shkrimit akademik, botimi III)*, Tiranë, 2013, f. 117-118.

¹²⁹ Propozim-ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për përdorimin e maqedonishtes mund ta gjeni në linkun: https://ener.gov.mk/Default.aspx?item=pub_regulation&subitem=view_reg_detail&itemid=56281&fbclid=IwAR07k9k65M_W-PPGLigSDsq9NPOK6mGt7twxsUogVaqHBTB1sjwgQChMM8E

¹³⁰ Предлог закон: Лектори по македонски јазик во сите институции и задолжителен предмет на факултетите. <https://kurir.mk/makedonija/vesti/predlog-zakon-lektori-po-makedonski-jazik-vo-site-institucii-i-zadolzitelenn-predmet-na-fakultetite>, 29. 12. 2019.

5. Të sillet një ligj për mbrojtjen e shqipes standarde

Shumë gjuhëtarë janë të mendimit se në tri shtetet (në Shqipëri, në Kosovë e në Maqedoninë e Veriut) duhet të zbatohen jo vetëm politika stimuluese, por edhe ndëshkuese; përkatësisht të miratohet një Ligj për mbrojtjen e gjuhës shqipe në përdorim publik dhe për ndëshkimin e keqpërdoruesve të saj.

6. Përveç gjuhës zyrtare të shtetit ku jetojnë, fëmijët shqiptarë duhet të mësojnë edhe gjuhën shqipe

Mërgata është ambasadori ynë më i mirë. Të gjithë krenohemi me arritjet kulmore të shqiptarëve që jetojnë jashtë atdheut në shkencë, në letërsi, në art, në sport e në fusha të tjera. Fëmijët që lindin, shkollohen e marrin kulturë bashkëkohore në diasporë janë investim i madh për të sotmen dhe të ardhmen e kombit. Dygjuhësia e shumëgjuhësia është e njohur në shumë vende të botës. Gjuha është e vetmja armë që vërteton se ne jemi shqiptarë kudo që ndodhemi. Vetëm përmes gjuhës mund të përcillet e kultivohet brez pas brezi edhe trashëgimia kulturore e shpirtërore kombëtare dhe vetëm në këtë mënyrë do të mund të ngadalësohet a pengohet asimilimi i shqiptarëve në mërgim. Pra, përveç inkuadrimin social në shtetin ku jetojnë dhe njohjes së gjuhës zyrtare, prindërit e kanë për detyrë e mision fëmijëve të tyre t'ua mësojnë edhe gjuhën shqipe. Me fjalë të tjera, mësimi i gjuhës shqipe është detyrë kombëtare e çdo shqiptari.

7. Në kushtetutën e Maqedonisë së Veriut të përcaktohet se shteti është shumënacional me dy gjuhë shtetërore

Edhe me Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve, që e miratoi Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut (11 janar 2018) shqipja në dokumentet zyrtare nuk mund të përdoret më vete, pa maqedonishten. Maqedonia e Veriut nga modeli me një gjuhë shtetërore, do të duhet të kalojë në modelin me dy gjuhë shtetërore. Shembull i mirë është Kosova, ku gjuha shqipe dhe gjuha serbe janë gjuhë zyrtare në nivel nacional, ndërsa gjuhët e minoriteteve janë zyrtare në nivel lokal. Në kushtetutën e Maqedonisë së Veriut duhet përcaktuar statusin e shqiptarëve si shtetformues dhe të shqipes si gjuhë zyrtare (të barabartë me maqedonishten).

8. Shtetet amë (Shqipëria, Kosova e Maqedonia e Veriut) të kujdesen më shumë për hapjen e shkollave me mësim plotësues në gjuhën shqipe

Arsimi me mësim plotësues në gjuhën amtare mban gjallë gjuhën shqipe dhe ndjenjën kombëtare. Fatmirësisht, shkolla për mësimin e shqipes ka në shumë vende ku ka shqiptarë. Synimi i këtyre shkollave mbetet i qartë: fëmijët e mërgimtarëve të zotërojnë mirë shkrimin e leximin në gjuhën amtare shqipe, ta kultivojnë atë dhe letërsinë shqipe, të njohin historinë dhe gjeografinë etnike të vendit të të parëve, si dhe artin, kulturën dhe traditat kombëtare. Shtetet shqiptare mund të ndihmojnë me programe të përshtatshme, mësimdhënës të aftë, me tekste të mira mësimore, të hartuara me metoda bashkëkohore për mësimin e gjuhës shqipe.

Thirrje për vetëdijësim

Kjo kumtesë, bashkë edhe me punimet e librat e botuar deri më tani e që do të shkruhen edhe në të ardhmen kushtuar kujdesit që duhet treguar ndaj gjuhës amtare çdo individ, institucionet e shoqëria shqiptare në përgjithësi, le të shërbejë si nxitje e thirrje për të gjithë shqiptarët: të mos e shpërfillim shqipen. Shqipja për ne është gjuhë e parë, gjuhë e nënës, gjuhë e zemrës; ndërsa cilado gjuhë tjetër është gjuhë e dytë, gjuhë e huaj, gjuhë e bukës. Të ngrihet vetëdija jonë se ruajtja e pasurisë dhe e pastërtisë së gjuhës, zbatimi i saj në praktikë është jo vetëm detyrë individuale e çdo shqiptari, por edhe detyrë kombëtare, sepse pastërtia e gjuhës është treguesi më i mirë i ruajtjes së pastërtisë së kombit. Gjuha shqipe ka qenë, është dhe do të mbetet tipari kryesor i kombit shqiptar. Nëse nuk mund të bëjmë më shumë për shqipen, atëherë së paku të mos e harrojmë, shpërfillim, përziejmë, shtrembërojmë, ndotim e prishim.

Literatura e konsultuar:

- [1]. Hajdari - Qamili, Ajten, *Perla gjuhësore*, Sak-stil, Shkup, 2018.
- [2]. Hamiti, Asllan, *Kultura e gjuhës për të gjithë*, Sak-stil, Shkup, 2018.
- [3]. Hamiti, Asllan, *Gjuha e teksteve shkollore të kimisë të arsimit fillor në Maqedoni*, Seminari V Ndërkombëtar i Albanologjisë, Tetovë – Shkup, 3-4. 10. 2011.
- [4]. Hamiti, Ismail, *Bazat e përkthimit dhe të interpretimit* (në dorëshkrim), Shkup, 2020.
- [5]. Ismaili, Qamuran, *Niveli i zbatimit të shqipes standarde në administratën publike në Shkup* (punim magjistrature i pabotuar, fondi i Fakultetit të Filologjisë “Bllazhe Koneski”), Shkup, 2015.
- [6]. Lloshi, Xhevat, *Stilistika dhe pragmatika*, Tiranë, 1999.
- [7]. Shkurtaj, Gjovalin, *Si të shkruajmë shqip* (Baza të shkrimit akademik, botimi III), Tiranë, 2013.
- [8]. Влада на Северна Република Македонија, Министерство за култура на СРМ, *Предлог на закон за употреба на македонскиот јазик*, Скопје, декември 2019 година.

Burime nga interneti:

- [1]. <https://kurir.mk/makedonija/vesti/predlog-zakon-lektori-po-makedonski-jazik-vo-site-institucii-i-zadolzitelen-predmet-na-fakultetite/> 29. 10. 2019.
- [2]. Prof. Asoc. Dr. Viktor Ristani, *Comparative Translation*, University of Tirana, Tiranë, 2011. (https://www.academia.edu/5840199/Krahasim_Perkthimi?auto=download&email_work_card=download-paper) zbritur nga interneti 14. 12. 2022.
- [3]. Klodian Briçi: *Përkthimi kërkon përkushtim, ndaj mos jini përtacë*, Tradita.org, <https://tradita.org/2020/05/27/tradita-org-wp-admin-post-phppost5087actionedit3/>
- [4]. http://infrastrukturerrugore.weebly.com/uploads/2/5/9/7/25973304/shkrimi_akademik_leksione.pdf
- [5]. https://ener.gov.mk/Default.aspx?item=pub_regulation&subitem=view_reg_detail&itemid=56281&fbclid=IwAR07k9k65M_W-PPGLigSDsq9NPOK6mGt7twxsUogVaqHBTB1sjwgQChMM8E
- [6]. <https://kurir.mk/makedonija/vesti/predlog-zakon-lektori-po-makedonski-jazik-vo-site-institucii-i-zadolzitelen-predmet-na-fakultetite>, 29. 12. 2019.